

Sabit SYLA

Fjala e hapjes

I nderuar Ministër i Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Z. Shyqiri Bytyqi, I nderuar ish-Ministër i Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Z. Ramë Buja, I nderuar Z. Ambasador Minxhozi, Të nderuar deputetë, përfaqësues të institucioneve shkencore, arsimore e kulturore, të medieve të shkruara dhe elektronike, kolegë e gjithë ju të pranishëm. Më lejoni fillimisht t’ju përshëndes në emër të Këshillit Organizativ, me falënderimet më të sinqerta për pjesëmarrjen tuaj në Konferencën shkencore: “Jasharajt dhe lufta çlirimtare”.

Të nderuara zonja dhe zotërinj,

Në vitet nëntëdhjeta, të shekullit XX, politika shtetërore serbe u shoqërua nga një rigjallërim i dukshëm nacionalizmi me mekanizmin e saj ushtarako-policor, duke vendosur me dhunë nën pushtetin e saj të gjitha strukturat institucionale politike, ekonomike, gjyqësore, policore, shëndetësore, kulturore e arsimore. Kosova u kthye në një qendër të vlimeve, revoltës e kundërshtisë, por edhe një nga poligonet më të mëdha të dhunës e të terrorit shtetëror. Në kundërpërgjigje të një politike të tillë, filluan edhe organizimet e para ushtarako-politike, me synim çlirimin nga sundimi i Serbisë përmes formës së luftës guerile dhe asaj frontale. Adem Jashari me bekimin edhe të familjes, qe ideator e pjesëtar i grupeve dhe celulave të para të luftës çlirimtare në Kosovë, të cilat i paraprinë dhe çuan deri te formimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të dy etapave të saj ilegale dhe legale, duke qenë edhe

koordinator e projektues i sulmeve të shumta kundër njësiteve ushtarake të ushtrisë serbe.

Mbështetur në realitetin e së vërtetës historike shkencore, se “liria nuk dhurohet, por fitohet”, familja Jashari e vetëdijshme për shkallën e rrezikshmërisë, dhe të bindur se pa luftë, pa gjak e flijime të dhimbshme, nuk ka e nuk mund të kishte çlirim, këtij parimi do t’i qëndrojnë besnikë dhe me gatishmëri e guxim të ndërgjegjshëm, këtë do ta tregojnë disa herë. Më 30 dhjetor të vitit 1991, e para u rreshtua në frontin e qëndresës, e kuptoi më qartë se kushdo tjetër detyrën që shtronte çasti historik, më 22 janar 1998, dhe së fundi në marsin e lavdisë e të krenarisë kombëtare, të mobilizimit e të masivizimit të shqiptarëve për luftën çlirimtare duke shënuar fillimin e kthesës së madhe në rrugën shekullore drejt lirisë sonë.

Në histori ka edhe ngjarje të rastësishme, por kjo, nuk ishte rastësi. Historia nuk njeh një rast të tillë të një familjeje, të përbërë nga breza luftëtarësh të devotshëm për çështjen kombëtare. Kjo natyrisht, është rezultat i përkushtimit total të familjes, për një qëllim të madh, që fund e krye ka pasur synim lirinë e popullit të vet. Familjet e tilla nderojnë secilin komb, por jo të gjitha kanë madhështi të tilla. Në histori, për një ditë, orë apo çast, kanë rënë qeveri, mbretëri e perandori. E familja Jashari, më 5, 6 dhe 7 mars, nuk ra. Ajo u ngrit në një mur të pakalueshëm përball, para të cilit ra fuqia e një pushtuesi shekullor të shqiptarëve. Kjo luftë heroike, tashmë në historinë e re, njihet me emrin Epopeja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që simbolizon në vetvete një epokë të re, së cilës i dha edhe emrin e vet, luftës kundër pushtimit serb për mbrojtjen e tokës, të lirisë e të pavarësisë, duke i dhënë fund *status quo-së* shumëvjeçare e nismë procesit të pandalshëm. Në analet e Epopesë, mënyra e funksionimit dhe disiplinës së lartë që demonstroi

familja Jashari, duke qenë një instrument i fuqishëm i bashkimit përtej të djathtës e të majtës, edhe për pastërtinë, seriozitetin dhe imazhin e saj në rrafshin kombëtar dhe ndërkombëtar, ushtarak, politik, diplomatik e mediatik mbetën përgjithmonë shembull i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me ndikim të veçantë e dallues, të pakrahasueshëm, unikat dhe përcaktues të fitores sonë kombëtare.

Të nderuar të pranishëm,

Konferenca që sot po i nis punimet, ka një rëndësi të veçantë në historinë më të re shqiptare, në të cilën do të trajtohen tema të ndryshme, duke ofruar materiale të reja, mbështetur në të dhëna dhe fakte shkencore dhe në metodologji të trajtimit bashkëkohor. Duke besuar se vetë kjo konferencë është në funksion të këtij kursi, presim rezultate të reja, të cilat, padyshim, do t'i shpijnë përpara studimet në fushën e historiografisë shqiptare e më gjerë, me argumente e përmes fakteve dhe të dhënave jo të njohura deri më tani, e kemi bindjen e plotë që do të pasqyrohet shkencërisht “Epopeja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”. Andaj, mbajtja e kësaj konference, ka një rëndësi të veçantë jo vetëm për institucionet tona të larta si organizator, por edhe për studimet historike në përgjithësi, duke e begatuar me prurje të reja dijen historiografike shkencore. Historiografia shqiptare, tashmë është në gjendje të përmbushë këtë nevojë të vetëdijes sonë kombëtare, të kulturës e kujtesës sonë historike. Sot, çasjet më ndryshe nga e kaluara dhe metodologjitë më të avancuara për shkrimin e historisë, janë një arsye më tepër për të qenë optimistë se do të hedhet dritë mbi çështjet e sipërthëna, për çështje të panjohura e të pastudiuara sa duhet për Jasharajt dhe luftën çlirimtare. Epopeja e UÇK-së, pret më shumë vlerësime shkencore në këtë drejtim dhe Instituti i Historisë mbetet i

angazhuar që kërkimit shkencor t'i japë rolin meritore që i takon në këtë drejtim.

Zonja dhe zotërinj,

Në mbyllje të fjalës sime, duke ju dëshiruar punë të mbarë e të frytshme dhe qëndrim të këndshëm të gjithë studiuesve ndërkombëtarë dhe atyre vendës, i shpall të hapura punimet e konferencës shkencore “Jasharajt dhe lufta çlirimtare”.

Ju faleminderit!